

Udhëzimet për aplikimin për IDNYC

PËR TË APLIKUAR PËR NJË KARTË IDNYC, DUHET TË PËRMBUSHNI KRITERET E MËPOSHTME:

1. Të paktën 4 pikë të dokumenteve, duke përfshirë të paktën 3 pikë për vërtetimin e identitetit dhe të paktën 1 pikë për vërtetimin e banimit.
 2. Të paktën 1 nga dokumentet e dorëzuara duhet të ketë një foto, me përjashtim të rastit kur aplikanti shoqërohet nga një kujdestar.
 3. Të paktën 1 nga dokumentet e dorëzuara duhet të përfshijë datëlindjen.
- Nuk do të pranohet asnjë dokument i pavlefshëm, me përjashtim të rastit kur përmendet specifikisht në udhëzuesin e dokumenteve të IDNYC. Do të pranohen vetëm dokumentet dhe kopjet origjinale të vërtetuara nga agjencia lëshuese; dokumentet e plastifikuara do të pranohen vetëm nëse janë lëshuar fillimisht në gjendje të plastifikuar.

KONSISTENCA E EMRAVE

Emrat në të gjitha dokumentet tuaja duhet të përputhen me njëri-tjetrin. Emri në aplikimin tuaj për IDNYC duhet të jetë i njëjtë me atë në dokumentin e identitetit me vlerën më të lartë (si për shembull pasaporta, leja e drejtimit, certifikata e lindjes, ID konsullore etj.) me përjashtim të rastit kur paraqitni gjithashtu një urdhër gjykatë, certifikatë martesë ose dokument tjetër të lëshuar nga autoritetet shtetërore që tregojnë një ndryshim të ligjshëm të emrit. Në rast se aplikanti paraqet dy dokumente identifikimi që vlejné të njëjtin numër pikësh, aplikimi në IDNYC duhet të shfaqë emrin në dokumentin me foto.

APLIKANTË TË MOSHAVE 14-21 VJEÇ PA IDENTIFIKIM ME FOTO APO VËRTETIM BANIMI

Aplikantët e moshës 14-21 vjeç pa identifikim me foto apo vërtetim banimi mund të aplikojnë nëse shoqërohen nga një kujdestar që mund të paraqesë dëshmi marrëdhënieje me aplikantin. Kujdestar i pranueshëm është prindi biologjik, prindi adoptues, njerku/a, kujdestari ligjor, prindi kujdestar, një punonjës i autorizuar i Administratës së Shërbimeve për Fëmijët të qytetit të Nju-Jorkut (NYC Administration for Children's Services, ACS) ose një agjenci e kujdesit tutorial e "ACS", ose një sponsor i rritur i një të mituri, i caktuar nga Departamenti i Shëndetit dhe Shërbimeve Njerëzore të SHBA-së, (U.S. Department of Health and Human Services), Zyra e Sistemit të Emigrantëve (Office of Refugee Resettlement).

APLIKANTË ME AFTËSI TË KUFIZUARA PA IDENTIFIKIM ME FOTO APO VËRTETIM BANIMI

Pavarësisht moshës, aplikanti me aftësi të kufizuara të cilit i mungon identifikimi me foto apo vërtetimi i adresës mund të aplikojë nëse shoqërohet nga një kujdestar i cili mund të paraqesë dëshmi të marrëdhënies me aplikantin. Kujdestarët e pranuar për aplikantë të çdo moshe përfshijnë: **punonjës të autorizuar** nga Zyra Shtetërore e Shtetit të Nju-Jorkut për Personat me Aftësi të Kufizuara Zhvillimore (OPWDD), nga Departamenti i Shëndetit i Shtetit të Nju-Jorkut (NYS DOH), nga Zyra Shtetërore e Nju-Jorkut për Shëndetin Mendor (NYS OMH), nga Departamenti i Shëndetit dhe Higjienës Mendore të Qytetit të Nju-Jorkut (NYC DOHMH), nga ACS, nga një agjenci kujdesi tutorial (foster care) e ACS ose nga një ofrues i OPWDD, NYS DOH ose NYC DOHMH, duke përfshirë **punonjësit e institucioneve të kujdesit rezidencial** të operuara, certifikuara, licencuara apo financuara nga OPWDD, NYS OMH, NYS DOH ose NYC DOHMH; **bashkëjetuesit e aplikantit** që është përcaktuar nga OPWDD si person me aftësi të kufizuara zhvillimore; ose një përfaqësues i aplikantit për pagesat e sigurimeve shoqërore.

TË GJITHË APLIKANTËT QË APLIKOJNË ME KUJDESTAR

Një aplikant që aplikon me një kujdestar duhet të ofrojë të paktën 2 pikë të dokumenteve që dëshmojnë identitetin, duke përfshirë datëlindjen. Aplikanti dhe kujdestari duhet të japin edhe dëshmi të marrëdhënies së kujdestarit siç listohet në seksionin e kujdestarit në udhëzuesin e dokumenteve të IDNYC. Kujdestari duhet të japë të paktën 3 pikë të dokumenteve që dëshmojnë identitetin e tij, duke përfshirë identifikim me foto. Nëse aplikanti nuk ka dokument për vërtetimin e banimit dhe jeton me një kujdestar, ky i fundit mund të tregojë vërtetimin e vet të banimit me anë të njërit prej dokumenteve të banimit të listuara në udhëzuesin e dokumenteve të IDNYC dhe duke dhënë një vërtetim që aplikanti banon me kujdestarin. Të gjithë kujdestarët duhet të nënshkruajnë aplikimin e IDNYC. Punonjësit që veprojnë si kujdestarë duhet të paraqesin dokumentin e tyre të identifikimit.

VENDBANIMI PËR APLIKANTËT E PASTREHË APO PËR TË MBIJETUARIT E DHUNËS NË FAMILJE

Një aplikant që jeton në një qendër për të pastrehët mund të japë një letër me adresën e vendstrehimit, duke deklaruar që ka banuar atje për të paktën 15 ditë dhe që vendstrehimi lejon banorët të qëndrojnë për të paktën 30 ditë. Adresa e qendrës së strehimit do të shfaqet në kartë. Aplikantit të cilit i mungon adresa e shtëpisë apo është i mbijetuar i dhunës në familje i kërkohet të vërtetojë banimin brenda qytetit të Nju-Jorkut, por mund të përcaktojë një organizatë jofitimprurëse ose një institucion fetar adresa e të cilit do të shfaqet në kartë si adresa e kujdestarit të aplikantit; ose të heqë adresën nga karta. Kartat IDNYC të cilat nuk shfaqin adresën ose që shfaqin adresën e kujdestarit mund të mos pranohen në rrethana të caktuara.

Aplikanti që vërteton se është pjesë e programit të Shtetit të Nju-Jorkut për konfidencialitetin e adresës apo banon në një qendër strehimi për të mbijetuarit e dhunës në familje në qytetin e Nju-Jorkut duhet të japë gjithashtu vërtetim që banojnë në qytetin e Nju-Jorkut. Karta e tyre IDNYC mund të shfaqë rutinë postare ose mund të mos shfaqë asnjë adresë.

STATUSI I VETERANIT

Nëse ju duhet ndihmë për marrjen e vërtetimit për shërbimin ushtarak, Departamenti i Shërbimeve për Veteranët i qytetit të Nju-Jorkut (NYC Department of Veterans' Services) mund t'ju ndihmojë. Mund t'i kontaktoni në internet në www.nyc.gov/veterans ose t'i telefononi në 311.

RINOVIM I KARTËS IDNYC

Kartat IDNYC mund të rinovohen deri në 60 ditë përpara skadimit të kartës. Periudha e rinovimit fillon 60 ditë përpara skadimit të kartës dhe përfundon 6 muaj pas skadimit të saj. Individit që kërkon një kartë mbi 6 muaj pas skadimit të saj do të trajtohet si aplikant i ri. Vizitoni qendrën e regjistrimit të IDNYC për ndihmë me rinovimin e kartës.

KARTAT ZËVENDËSUESE

Aplikimi për zëvendësimin e një karte të humbur, të vjedhur apo të dëmtuar ka një tarifë prej 10 dollarësh, me përjashtim të rastit kur aplikanti nënshkruan një falje dënimi për shkak të vështirësive ose ka një dokument zyrtar që vërteton se i kanë vjedhur kartën. Pagesat për kartat zëvendësuese duhet të bëhen pranë një qendre regjistrimi të Departamentit të Financës së IDNYC (IDNYC Department of Finance Enrollment Center).